



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Agim Ramadani Nr. 23, Prishtinë - Kosovë **Tel:** ++381 38 500 400 0 **Fax:** ++ 381 38 248 076

E-mail: info@pak-ks.org; www.pak-ks.org

Me qëllim të përshejtimit të procedurës së përfitimit të një pjese prej 20% të të ardhurave nga privatizimi-shitja e Ndërmarrjes Shoqërore "BANKKOS" Prishtinë, e në përputhje me nenin 10, të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 (me ndryshime) dhe Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45, Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm "Agjencia") në bashkëpunim me Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), shpall këtë:

NJOFTIM LIDHUR ME PËRPILIMIN E LISTËS FILLESTARE TË PUNËTORËVE TË NSh "BANKKOS" NË PRISHTINË

Njoftohen të gjithë ish punëtorët e NSh "Bankkos" Prishtinë, se pas vendimit final të Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-16-0058-A1-A17, të datës 15 korrik 2016, **në tërësi është shpallur e pavlefshme Lista Përfundimtare e Punëtorëve e kësaj NSh-je**, e publikuar në muajin Janar 2014 nga Agjencia, me ç'rast **është kërkuar që të përsëritet nga fillimi procedura e pëpilimit të listës**, duke filluar nga Lista Fillestare, e cila do të hartohet nga BSPK, në pajtim me nenin 10, paragrafi 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime) dhe 2004/45.

Lidhur me këtë ftohen të gjithë ish punëtorët e kësaj NSh-je të cilët përmbushin kushtet e kualifikueshmërisë të parapara me rregulloret e lartcekura në fuqi, të dorëzojnë dëshmitë e tyre mbi punësimin, në adresën e shënuar më poshtë dhe atë:

1. Librezën e punës (për punëtorët që i posedojnë ato);
2. Në rastet kur mungon Libreza e punës, çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon themelimin e marrëdhënies së punës në këtë NSh;
3. Vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës gjatë viteve 1990-1998, gjatë aplikimit të masave të dhunshme diskriminuese nga ish Kuvendi i Republikës së Serbisë (nëse disponojnë me këtë vendim);
4. Dokumentet në komunat përkatëse për të rënë në Luftën e Kosovës 1998-1999, qoftë luftëtarët e lirisë, por edhe të viktimave civile;
5. Çfarëdo dokumentacioni tjetër i cili dëshmon dhe arsyeton pretendimin për të drejtën e punëtorit për tu përfshirë në Listën fillestare në formatin excel, të cilin e harton BSPK-ja.
6. Të gjitha dokumentet e dorëzuara duhet të jenë të legalizuara nga noteri kompetent;

Punëtorët të cilët në vitin 2013 i kanë dorëzuar në Agjenci dëshmitë e tyre mbi punësimin në këtë NSh, në original apo të noterizuar, mund ta tërheqin atë me një kërkesë paraprake, në mënyrë që të njëjtin t'a shfrytëzojnë për të aplikuar rishtazi, tani për përfshirje në Listë Fillestare për përfitimin e 20% nga shitja e NSh-së, e cila do të përgatitet nga BSPK.

Për shkak të mungesës së hapsirës në zyrat e BSPK-së, të gjithë të interesuarit mund t'i dorëzojnë dëshmitë e tyre mbi punësimin për çdo ditë pune nga ora **09:00-15:00**, në AKP: **Rr. Agim Ramadani, Nr. 23, Prishtinë (Personi kontaktues: z. Zeqir Shkodra, Tel: 044/419-083)**. Gjersa afati për paraqitjen e këtij dokumentacioni fillon nga **22 gusht** e deri me **18 tetor 2017** para përfundimit të orarit të punës.